KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

PROCESVERBAL IX/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IX (nëntë) për vitin 2026 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: **KK Suharekë**
Zyra: **Salla e Bordit të Drejtorëve**
Data: **17.09.2026**
Ora : **10:00**

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Flamur Bytyçi
z.Enver Shabani
znj.Mimoza Bajraktari
znj.Sanie Kuçi Rexhepaj
znj.Laureta Tafaj
z.Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

1 .Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2027;

3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit AUV-in;

6. Raporti për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratave për pronat publike për periudhen janar-qershor 2026;

Kryesuesi- i njofton me rendin e ditës dhe e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2027;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin
Flamur Bytyçi-përshendetje për të gjithë,a e keni bë plan me mbajtë një ndëgjim publik para se me e sjellë në Asamble?
Avni Bytyçi-përshendetje për të gjithë, ne si zyre e Kuvendit e kemi pa të arsyeshme që këtë çështje ta diskutojm me KPF-në pasi që edhe e ligji për vetë qeverisje lokale e obligon KPF-në në hartimin e projekt-buxhetit,çështjen e organizimit të ndëgjimeve publike i ka shtjerrë Ekzekutivi dhe nuk e ka pa të arsyeshëme Kryesuesi të organizojë një takim të tillë për arsye se edhe nga

ndëgjimet publike që i ka organizu Ekzekutivi nuk ka pas pjesëmarrje të knaqëshme të qytetareve dhe vetëm sa për obligim nuk e kemi pa të arsyeshme me organizu ndëgjim publik.
Sanie Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë,e kam analizu këtë projekt aq sa kam pas mundësi dhe realisht mendova që ka mem marrë shumë koh shqyrtimi i këtij projekt-buxhetit dhe kur mora me shqyrtu 90% e projekt buxhetit është ndërtimi i rrugëve,te Drejtoria e Urbanizmit mendon që ka ndonjë projekt madhor prap ndërtimi i rrugëve edhe aty,te Drejtoria Bujqësis sheh që Drejtori është fokusu në Studenqan,Kultur Rini dhe Sport jan qështje të përgjithshëme,ashtu edhe të Shëndetësia,Administrata,dmth nuk ka ndonjë projekt madhor që është tu planifiku për vitin e ardhshëm në Komunën e Suharekës në projekt buxhetin ton,po kthehemi një vit më par prej partisë juj është paraqit ndërtimi i Shkollës 7 Marsi projekt i cili daton prej kur kam qenë Drejtoreshë në vitin 2012 qdo ditë është paraqit në projekt-buxhet dhe asnjëherë nuk është bë,që dy vite e keni hek komplet prej planifikimit buxhetit,keni fol edhe për palester, pishin gjysëm olimpike,keni fol për varrezat e qytetit që sot nuk jan kërkun dhe shumë projekte madhore që jan prezantu nga ju që kan me fillu nga viti 2027 ku në projekt-buxhet nuk po pasqyrohen,mos të flasim për Arsim tepër e nevojshëm mësimi tër ditor në Shkollat e Qytetit të paktën me fillu,kështu jan prezantu prej Kryetarit në debatet politike para zgjedhore,asnjë investim për mësimin tër ditor,unë personalisht mendojë që ky projekt-buxhet ka të meta dhe ka çështje që duhet me u planifiku shumë më mirë se sa mënyra qysh e keni planifiku,u ndala pak te disa çështje pak më të vogla me thën por që lypin specifikim psh te ndërtimi i zonave të gjelbëruara rekreative në Suharekë dhe Komunë mirë është me u specifiku ku kan me u bë,blerja e autofshesës për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve po besojë që është projekt i Eko-Therandës dhe kjo çështje a planifikohet te Eko-Theranda si Ndërmarrje a duhet procedurat me i zhvillu vetë Ndërmarrja apo Komuna,vendosja e anësorëve te zona industriale dmth tash paskemi të drejtë ne me investu sepse deri tash e keni pas arsyetimin nuk kemi të drejtë ne me vendosë është rrugë që menaxhohet nga Ministria,ndërtimi i rrugëve lokale Avdi Kuqi segment është i njejti projekt që po perseritet mbrenda për mbrenda këtij projekt buxheti,ndërtimi i zonave infrastrukturore Smart po më intereson me ditë qka saktësisht është tu u bë me Smart city sepse smart nuk jemi duke pa në qytet,ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve në zonën urbane në Suharekë,është projekt i planifikum te Drejtoria Urbanizmit mirpo i njëjti është edhe te Drejtoria e Shërbimeve Publik nuk e di dallimin,ndërtimi dhe rikonstruimi i QKMF-së në Suharekë,a ka me u rikonstru u QKMF apo ka me u ndërtu e re këtu me bë dallimin,ku sipas informatave që kam një projekt që është të zhvillu Ministri ka me u ndërtu në atë vend ku është pse duhet me u rikonstru u QKMF ku ka me u bë një e re,këto jan pyetjet konkrete në planifikim të buxhetit për ndryshe për mu është një planifikim shumë i mangët.
Kryesuesi- e hedhë në votim

3 për,2 kundër,1 abstenim miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin
Kryesuesi-pasi nuk ka debat e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pikaa 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin
Kryesuesi-pasi nuk ka debat e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit AUV-in;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin
Flamur Bytyçi-kush e menaxhon atë pjesë mas anej?
Kryesuesi-Komuna
Sanie Kuçi Rexhepaj- e pashë që këtë zonën ku kta kan planifiku po përputhet edhe me destinim përshkak se edhe me hartë zonale është e planifikume,mirpo me sa e di pa u miratu hartat zonale Kuvendi në periudhen 2021/22 ka marrë një vendim që atë zon me nda për varreza por mos ka diqka specifike që mundet me ra në kundërshtim me vendimin që tash po e marrim dhe me specifiku qartë ktët projekt-vendimin tonë por në anën tjetër sa kam qenë unë Drejtoreshë në atë zonë është hartu projekti kryesor për varrezat e qytetit mirë është ndoshta me drejtorin e Urbanizmit,Drejtorë veq me kontrollu mos po bjen ndesh diqka ajo pjesë me projektin kryesor të varrezave.
Kryesues-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Raporti për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratave për pronat publike për periudhen janar-qershor 2026;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin
Flamur Bytyçi-ky raport është për kontratat janar-qershor dmth? Informatë shumë e thejshtë kjo u marrë nuk u marrë unë po du me ditë pak ma detajisht qka ka ndodhë edhe me pagesat mirpo këtu nuk është as Kryetari as Nënkryetarja.
Sanie Kuçi Rexhepaj-nëse mendoni që me këtë raport jeni te përmbush obligimin ligjor ose jeni duke marrë pikë te grandi përformancës atëherë në përmbajtje nuk është qka kërkohet me ligj,pikërisht në ligj thuhet që Kryetari i Komunës obligohet që në raport të tij të rregullta 6 mujore ti paraqes Kuvendit Komunal raportin e veqantë të monitorimit të realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënjes në shfrytëzim të pronave të paluajtëshme deri në fillim implementimin dhe arritjen e qëllimit të dhën të pronës në shfrytëzim,ky raport nuk paraqet a jan përmbush apo nukmjan përmbush obligimet që kan qenë në kontrat është një raportim sipërfaqësor kështu që obligim ligjor nuk jeni duke përmbushë
Kryesuesi- e hedhë në votim

4 për 2 kundër miratohet

Takimi përfundoi-10:30